



KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në Udhëzimin administrativ nr.19/2018 për themelimin dhe funksionalizimin e qendrave mësimore (tutje në tekst:UA) të aprovuar nga Ministira e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me datën 7 Dhjetor 2018;

Në përputhje me Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve romë dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021, e cila prezanton vazhdimësinë e politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e të cilat shërbejnë për fuqizimin e karakterit multi-kulturalizëm në shoqërinë kosovare;

Në përputhje me Deklaratën e Poznanit të nënshkruar së fundmi nga partnerët e Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së, në të cilin kryeministrat e Ballkanit Perëndimor ritheksojnë angazhimin e tyre për integrimin e Romëve në shoqëritë tona, si dhe zotohen të rrisin përpjekjet e tyre si pjesë e procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe bashkëpunimit rajonal; dhe

Në përputhje me përpjekjet e vazhdueshme të Komunës së Vushtrrisë për të përkrahur integrimin e komuniteteve rom dhe ashkali të përcaktuar në Planin e veprimit local të komunës së Vushtrrisë, arrihet;

ANEKSI I TRETË I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

në mes të

OJQ-Terre des Hommes Kosovë, përfaqësuar nga znj.Florina Duli Sefaj, Drejtoreshë për Kosovë (referuar më poshtë si "Tdh") dhe

Komuna e Vushtrrisë e përfaqësuar nga z.Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës (referuar më poshtë si "Komuna")

Neni 1

Bazuar në nenin 6 paragrafi 6.2 të Marrëveshjes bazë/Marrëveshjes së Bashkëpunimit 02Nr. 427/21 datë 06.04.2021, Komuna e Vushtrrisë dhe OJQ-Terre des hommes Kosovë, pajtohen që në kuadër të personelit të angazhuar në Qendrën mësimore në Komunën e Vushtrrisë, sipas Aneks Marrëveshjes 02Nr. 428/23 datë 06.04.2021, neni 1 paragrafi 3 pika 2, në vend të znj. Linddita Bala e cila ka dhënë dorëheqje nga vendi i punës në qendër, caktohet znj. Akter Hoti me përgatitje profesionale Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve.

Neni 2

2.1 Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin e përfaqësuesve të autorizuar të palëve.

Neni 3

2.2 Kjo marrëveshje është hartuar në 3 (tri) kopje identike, 1 (një) për OJQ-Terre des Hommes në Kosovë, ndërsa 2 (dy) kopje për Komunën e Vushtrrisë.

Palët nënshkruese,

Komuna e Vushtrrisë

08/03/2023



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës



Terre des hommes,

08/03/2023



Florina Sefaj

Drejtoreshë për Kosovë

